

596/22



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA	
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / Telo Zakonodavte - Prokurorja	
Nr./Br.	74/23
Date/Datum	25.01.23
PRISHTINË - PRISTINA	

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:277079

Datë: 10.01.2023

Numri i dokumentit: 03839590

A.nr.2954/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Liridona Ajeti Kajtazi, në çështjen juridike sipas padisë të paditësit/propozuesi Ministria e Shëndetësisë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit, me bazën anulim vendimi, me propozim për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, jashtë seancës me datën 10.01.2023 merr këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë padia dhe propozimi i paditësit/propozuesit Ministria e Shëndetësisë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit, nën shenjë A.nr.2954/2022 datë 23.12.2022, si e palejueshme.

A r s y e t i m

Gjykata fillimisht mori parasysh vendimin AN.nr.1/2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me kompetencën lëndore të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative.

Paditësi/propozuesi Ministria e Shëndetësisë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me padi/plotësim të padisë ka kërkuar anulimin e vendimit nr.596/22 datë 21.12.2022, me propozim për shtyrje të ekzekutimit të w njëjtit.

Kjo gjykatë fillimisht ju referua Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), përkatësisht nenit 9 të të njëjtit, i cili përcakton se:

“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative”.

Ndërsa neni 10 paragrafi 1 i Ligjit për Konfliktet Administrative përcakton se:

“Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes ligjor”.

Me nenin 15 të Ligjit për Konfliktet Administrative përcaktohet:

“1. Konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet;

1.2. kundër akteve të nxjerra në çështjet rreth të cilave, sipas dispozitës së ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ;

Me nenit 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ku përcaktohet se:

“2.Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

6.Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni”.

Me nenin 34 të Ligjit për Konfliktet Administrative përcaktohet se:

“1. Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se:

1.1. padia është paraqitur pas kalimit të afatit ose është e parakohëshme;

1.5. është fjala për çështjen për të cilën sipas dispozitës shprehimore të ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ;

2. Për shkaqe të parashikuara në paragrafin 1. të këtij neni, gjykata mund të hedhë poshtë padinë në çdo fazë të procedurës”.

Andaj gjykata vlerëson se vendimi PSH.nr.596/22 datë 20.12.2022 i organi më të lartë administrativ, anulimi i të cilit kërkohet sipas padisë dhe shtyrja e ekzekutimit të të njëjtit, me të cilin e paditura anulon vendimin e datës 20.10.2022 dhe aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim, në këtë kuptim vendimi i atakuar me të cilin anulohet akti administrativ i organit më të ulët administrativ dhe obligohet organi administrativ në rivlerësim të aktiviteti të prokurimit nuk përbën akt përfundimtar administrativ, pasi që me aktin administrativ PSH.nr.596/22 datë 20.12.2022 kemi të bëjmë me kontroll administrativ nga vetë organi administrativ i shkallës më të lartë, për faktin se me të njëjtin anulohet vendimi i datës 20.10.2022 dhe çështja kthehet në rivlerësim lidhur me aktivitetin e prokurimit. Andaj me vendimin e të paditurës në pikën dy të tij obligohet paditësi që në afat prej 10 ditësh ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me aktivitetin e prokurimit. Gjykata në kuptim të neni 9 të Ligjit për Konfliktet

Administrative, konstaton se vendimi i atakuar me padi, me propozim të shtyrjes së ekzekutimit të të njëjtit nuk përbën vendim përfundimtar administrativ.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 34 paragrafi 1.5 lidhur me neni 9 dhe nenin 22 paragrafi 7 të Ligjit për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.2954/2022, me datë 10.01.2023

G j y q t a r j a

Liridona Ajeti Kajtazi



Këshillë Juridike: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

GJYKATA THEMELORE
PRISHTINË

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	02
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-334
Data: Datum:	20.01.2023
Nr. i faqeve Broj strana No. pages	-16-
Prishtinë / a	

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative

NR. SHKR. BR. SPISA
për

GJYKATËN E APELIT

PADITËSI:

“Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës” të cilën sipas Autorizimit Ligjor sipas bazuar në Nenin 18 të Ligjit NR. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura e Përfaqëson Sekretari i Përgjithshëm Dr. Naim Bardiqi, tash e tutje referuar si “Paditësi”

I PADITUIRI:

Organi Shqyrtues i Prokurimit me adresë në rrugën “Migjeni” (ish-Banka e Ljubljanes, Kati V-të), Prishtinë, tash e tutje referuar si e “Paditura”

DATË:

20.01.2023

Në përputhje me Nenin 49 të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, tash e tutje referuar si “Ligji për Konfliktet Administrative,” dhe Nenit 182 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, tash e tutje referuar si “Ligji për Procedurën Kontestimore,” Propozuesi, përmes të autorizuarit të tij, parashtron këtë:


ANKESË

kundër

Aktvendimit me numër A.Nr. 2954/2022, të datës 10.01.2022, të pranuar nga Propozuesi me datë 12.01.2022

Për shkak të:

- shkeljes së dispozitave të procedurës;
- shkeljes së ligjit material

 REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES / GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHENDETESISË / MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org Org. Jedinica Org. Unit	02
Nr. I faqeve Br. stranica No. pages	- 208 -
Nr. P. Ind. Broj. Ind. No. Ind.	05-6853
Data Datum Date	23.12.2022
Prishtinë / a	

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

PADITËSI: “Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës” të cilën sipas Autorizimit Ligjor sipas bazuar në Nenin 18 të Ligjit NR. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura e Përfaqëson Sekretari i Përgjithshëm Dr. Naim Bardiqi, tash e tutje referuar si “**Paditësi**”

E PADITURA: Organi Shqyrtues i Prokurimit me adresë në rrugën “Migjeni” (ish-Banka e Ljubllanës, Kati V-të), Prishtinë, tash e tutje referuar si e “**Paditura**”

DATË: 22.12.2022

Bazuar në Nenin 99, paragraf 3, të Ligjit 04/L-042 për “Prokurimin Publik,” ashtu siç është ndryshuar dhe plotësuar, tash e tutje referuar si “**Ligji për Prokurimin Publik,**” Neneve 26 dhe 27 të Ligjit nr. 03/L-202 për “Konfliktet Administrative,” tash e tutje referuar si “**Ligji për Konfliktet Administrative,**” në lidhje me Nenin 124, paragraf 6, nën-paragrafi 6.2m të Ligjit nr. 05/L -031 për “Procedurën e Përgjithshme Administrative,” tash e tutje referuar si “**Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative,**” Paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor, parashtrohet këtë:

PADI

për

Anulimin e Vendimit nr. 596/22, të datës 21.12.2022 të nxjerrë nga e Paditura, i pranuar nga Paditësi me po të njëjtën datë

DHE

KËRKESË

për

Shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit nr. 596/22, të datës 21.12.2022 të nxjerrë nga Kundërpropozuesi, i pranuar nga Propozuesi me po të njëjtën datë

1. HYRJE

1. Paditësi në cilësi të Autoriteti Kontraktues ka iniciuar Aktivitetin e Prokurimit me titull *“Furnizim me Insulina Analoge nga Lista Esenciale”* me numër të prokurimit 206-20-8397-1-1-1. Ky Aktivitet i Prokurimit është iniciuar për lidhjen e kontratës publike kornizë me afat prej 24 muajsh me vlerë të parashikuar të kontratës në lartësi prej 7,024,056.00 Euro (vlerë e madhe), tash e tutje referuar si **“Kontrata.”** Publikimi i Njoftimit për Kontratë është bërë me datë 12.12.2020 dhe me datën 25.12.2020 janë publikuar sqarimet e dosjes së tenderit sipas kërkesave të operatorëve ekonomik.

Provë 1: Njoftimi për Kontratë i datës 12.12.2020

2. Kriter kryesor për dhënien e Kontratës ishte oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë. Ndër të tjera dosja e tenderit ka pasur disa kërkesa duke përfshirë atë që produkti të ketë Autorizim Marketing, pra të jetë produkt i regjistruar pranë Agjencisë për Produkte dhe Pajisje Medicinale ashtu siç kërkohet me Ligjin për Pajisje dhe Produkte Medicinale. Dosja e tenderit poashtu ka paraparë që në rast se nuk ka produkt me Autorizim Marketing apo nuk ka paralele të regjistruar në Republikën e Kosovës të aplikohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ 02/2014 për Thjeshtëzimin e për Regjistrimin dhe Importin e Produkteve Medicinale të cilat nuk kanë Paralele të Regjistruara në Republikën e Kosovës, tash e tutje referuar si **“Udhëzimi Administrative 02/2014.”**
3. Me datë 05.01.2021 ka përfunduar afati për dorëzimin e ofertave dhe është bërë hapja e tyre dhe leximi i ofertave financiare. Nga procesverbali për hapjen e ofertave, vërehet se kishin aplikuar tre operatorë ekonomik duke përfshirë Pharma Leader, Lego dhe Meditech.

Provë 2: Procesverbali i hapjes së ofertave i datës 05.01.2021

4. Pas vlerësimit të ofertave, me datë 22.02.2021 Ministria e Shëndetësisë publikon Njoftimin për Vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilën rekomandon për dhënie të kontratës për llotët 1 dhe 3 operatorin ekonomik Pharma Leader ndërsa për llotin 2 operatorin Meditech. Nga gara është eliminuar operatori ekonomik Lego i cili kishte aplikuar me produktet e prodhuesit Novo Nordisk por që këto produkte me Autorizim Marketingu i ka të regjistruara operatori tjetër Meditech në Kosovë dhe sipas Ligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale ka të drejtën ekskluzive të shitjes së këtij produkti.

Provë 3: Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 22.02.2021

5. Brenda afatit ligjor operatori Meditech paraqet Kërkesë për Rishqyrtim kundër vendimit të lartëcekur me arsyetimin se insulinat e operatorit ekonomik Pharma Leader nuk janë të regjistruara me Autorizim Marketingu dhe si të tilla nuk mund të importohen, promovohet dhe shitet në tregun e Kosovës. Ministria e Shëndetësisë, pasi që ka analizuar Kërkesën për Rishqyrtim dhe pretendimet e ngritura aty, ka ardhur në përfundimin se sipas Nenit 3, paragraf

1, nën-paragrafi 43, lidhur me Nenin 16 të Ligjit nr. 04/l -190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale e njëjta është e bazuar dhe e ka aprovuar në tërësi këtë Kërkesë për Rishqyrtim dhe lëndën e ka rivlerësuar.

Provë 4: Vendimi mbi Kërkesën për Rishqyrtim të datës 01.03.2021

6. Me datë 05.03.2021 Ministria e Shëndetësisë publikon Njoftimin e ri mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin shpall fitues operatorin Meditech edhe për llotet 1 dhe 3 dhe eliminon si të papërgjegjshëm operatorin tjetër Pharma Leader për shkak të mungesës së Autorizimit për Marketing.

Provë 5: Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 05.03.2021

7. Brenda afatit ligjor operatori Pharma Leader paraqet Kërkesë për Rishqyrtim me arsyetimin se produkti i tij i plotëson kushtet për import, pasi që dallon ATC Kodi, përkatësisht shifra 5 e tij dhe për këtë arsye i njëjti i nënshtrohet përjashtimit dhe i lejohet importi pasi që produkt nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë. Ministria e Shëndetësisë përmes Vendimit për shqyrtimin e Kërkesës për Rishqyrtim, e refuzon të njëjtën me arsyetimin se Autorizimi për Marketing në rastin përkatës ekziston për insulinat e kërkuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe nuk mund të aplikohet përjashtimi.

Provë 6: Vendimi për Rishqyrtimin e Kërkesës për Rishqyrtim të datës 12.03.2021

8. Operatori ekonomik i pakënaqur me përgjigjen e Ministrisë së Shëndetësisë me datë 17.03.2021 dorëzon ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit . Organi Shqyrtues i Prokurimit i cili ishte në përfundim të mandatit e kishte shqyrtuar këtë ankesë brenda një afati rekord prej 7 ditësh dhe kishte aprovuar ankesën si të bazuar. Përkundër se ky fakt linte shumë dyshime se si është e mundur që kjo ankesë të ketë këtë prioritet, ndërsa në të gjitha rastet e tjera Ministria e Shëndetësisë pret për vendimet e OSHP-së të paktën 40 ditë deri në nxjerrje të vendimit. OSHP këtë vendim e ka marrë pa dëgjimin e palëve dhe pa publik e që po ashtu ishte përjashtim nga rastet e tjera, ku palët ftoheshin ti arsyetojnë pretendimet e veta. Në këtë vendim të OSHP-së ku Ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar thuhej: *"Përkundër kësaj nëse AK edhe më tutje ka dilema rreth autorizimeve dhe dëshmi të bashkangjitura nga OE ankuese ndërlidhur me produktet e ofertuar atëherë me rastin e rivlerësimit mundet që konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkojë sqarime nga kompanitë të cilat i kanë lëshuar autorizimet dhe dëshmitë tjera si dhe nga AKKPM-ja, për ti vërtetuar dëshmitë e bashkangjitura nga OE ankues."*

Provë 7: Vendimi i OSHP 240/21 i datës 25.03.2021

9. Me datë 27.04.2021 pas rivlerësimit të ofertave Ministria e Shëndetësisë sërish rekomandon për dhënie të kontratës operatorin Meditech pasi që është i vetmi operator që ka aplikuar me Autorizim Marketingu.

Provë 8: Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 27.04.2021

10. Operatori ekonomik Pharma Leader sërish paraqet Kërkesë për Rishqyrtim e cila refuzohet nga Ministria e Shëndetësisë e për rezultat përsëri ankohet në OSHP. Për shkak se OSHP nuk ka pasur Bord funksional, ankesa mbetet e patrajtuar dhe me ardhjen e Bordit të ri, për shkak se OSHP-së i kishin kaluar afatet ligjore për të nxjerr vendim, ankesa hudhet poshtë si jashtë afatit për shqyrtim, rrjedhimisht mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Provë 9: Vendimi i OSHP i datës 25.07.2022 me numër 397/21

11. Ministria e Shëndetësisë për shkak se kishte kaluar afat i gjatë dhe çmimet në treg kishin pësuar zbritje pas këtij vendimi vendosi që ta anuloi aktivitetin e Prokurimit.

Provë 10: Vendimi i datës 12.08.2022

12. Kërkesë për Rishqyrtim kundër këtij vendimi për anulim paraqesin dy operatorët ekonomik Meditech dhe Pharma Leader dhe që të dy Kërkesat për Rishqyrtim refuzohen nga Ministria e Shëndetësisë.

Provë 11: Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim për Pharma Leader i datës 02.09.2022

Provë 12: Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim për Meditech i datës 02.09.2022

13. Të pakënaqur me vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë të dy operatorët ankohen në OSHP kundër vendimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me arsyetimin se është shkelur Neni 62 i Ligjit të Prokurimit Publik. OSHP me datën 11 tetor 2022 ka nxjerr Vendimin Nr. 397, 409/22 me të cilin ka aprovuar ankesën e operatorit Pharma Leader dhe ka kthyer lëndën në rishqyrtim, me të cilën ndër të tjera ka konstatuar se kërkesa për Autorizim Marketing është kufizim i panevojshëm i konkurrencës, duke rrezikuar kështu jo vetëm furnizimin me insulina jo cilësore, por edhe krijimin e precedentit i cili do të bënte Autorizimin për Marketing të panevojshëm në aktivitete të prokurimit, pasi që të gjithë operatorët do të kërkonin që sipas Udhëzimit Administrativ të bëjnë shitjen e produkteve për Ministrinë e Shëndetësisë. Kjo do të binte në kundërshtim të hapur me Ligjin për Produkte Pajisje Medicinale, Neni 16, opinionin ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë, rekomandimet e Agjencisë Anti-Korrupsion e cila në të

kaluarën ka kërkuar që Autorizimi për Marketing të jetë pjesë e aktiviteteve të prokurimit madje edhe kur nuk kërkohet në Dosje të Tenderit.

Provë 13: Vendimi me numër 397, 409/22 i datës 11 tetor 2022

14. Paditësja e pakënaqur me këtë vendim të cilin e konsideronte të paligjshëm, përmes Avokaturës Shtetërore ka dorëzuar padi në Gjykatë së bashku me kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit.

Provë 14: Padi dhe kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit.

15. Duke parë se Vendimi Nr. 397, 409/22 i të Paditurës ishte nxjerr duke u thirrur dhe keqinterpretuar Udhëzimin Administrativ 02/2014, dhe duke marrë parasysh se Udhëzimi Administrative 02/2014 me opinion të Departamentit Ligjor të Paditëses ishte konstatuar se është në shpërputhje me Ligjin për Produkte dhe Pajisje Medicinale, Paditësi me datën 19.10.2022 ka nxjerr vendim për plotësim ndryshim të planit legjislativ dhe ka vendosur që të ndryshoj dhe plotësoj Udhëzim Administrative 02/2014 për shkak se i njëjti ka qenë i kundërligjshëm.

Provë 15: Vendimi me nr. 05-5271 i datës 19.10.2022

16. Pas plotësimit të planit Legjislativ, Qeveria nxjerr Vendim për anashkalimin e të gjitha procedurave të konsultimeve publike dhe lejon ndryshimin e Udhëzimit të kundërligjshëm me procedura të përsheptuara, duke parë rrezikun e shëndetit kombëtar nga Vendimi i të Paditurës dhe efektet që mund të krijohen në praktikë.

Provë 16: Shkresa e Kryeministrit me nr. 069/59

17. Duke vepruar mbi bazën e vendimeve të lartcekura është themeluar grupi punues i cili ka hartuar Udhëzimin e ri administrativ, i cili e pamundëson importin e pakufizuar të produkteve dhe pajisjeve medicinale pa Autorizim të Marketingut. (**Shih** Udhëzimin Administrativ për Thjeshtëzimin e për Regjistrimin dhe Importin e Produkteve Medicinale të cilat nuk kanë Paralele të Regjistruar në Republikën e Kosovës të datës 21.10.2022.)
18. Meqë Paditësi nuk kishte pranuar ende Aktvendimin e gjykatës mbi aprovimin apo refuzimin e kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, e njëjta duke vepruar në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik ka caktuar Komisionin për Rivlerësimin e ofertave në përbërje nga specialist të endokrinologjisë. Të njëjtit brenda afatit ligjor me datën 20.10.2022 kanë nxjerr raportin e vlerësimit me të cilin i kanë rekomanduar zyrtarit përgjegjës të prokurimit që për shkak të mungesës së Autorizimit për Marketing (Autorizimi për Marketing është Leje e dhënë

nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale për aprovimin e barit për treg bazuar në plotësimin e kërkesave për kualitet, siguri dhe efikasitet për përdorim human në tretmanin terapeutik) të shpallet si i papërgjegjshme Operatori Ekonomik Pharma Leader. Tutje zyrtari përgjegjës i prokurimit ka vërejtur se ofertat e operatorëve ekonomik kanë pasur edhe shprehje në validitetin e tyre dhe duke u bazuar në këto dy arsye të lartcekura ka nxjerr vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit, për ti hapur rrugë ritenderimit të këtij artikulli.

Provë 17: Njoftimi mbi vendimin e AK i datës 20.10.2022

19. I pakënaqur me këtë vendim Operatori Ekonomik Pharma Leader sërish ka dorëzuar kërkesë për rishqyrtim dhe pasi që e njëjta është refuzuar nga Autoriteti Kontraktues, me datën 28.10.2022 ka dorëzuar Ankesë tek e Paditura.

Provë 18: Ankesa e Operatorit Pharma Leader e datës 28.10.2022

20. E Paditura ka angazhuar ekspertin e saj të brendshëm profesional i cili ka dorëzuar ekspertizën e vet me datë 18.11.2022 (pas skadimit të afatit ligjor sipas Nenit 114 të Ligjit të Prokurimit Publik) ka dorëzuar raportin me rekomandimin që të aprovohet ankesa e operatorit ekonomik dhe lënda të kthehet në rivlerësim. I njëjti këtë e ka bërë duke u referuar në Nenin 70 të Ligjit të Prokurimit Publik, i cili flet për standarde e cilësisë dhe duke e injoruar Ligjin për Pajisje dhe Produkte Medicinale i cili është Ligj i veçantë për këtë materie. Ndër të tjera eksperti e ka kontestuar edhe anulimin e aktivitetit të prokurimit për shkak të validitetit të ofertave dhe caktimin e endokrinologëve në komision vlerësues me arsyetimin se të njëjtit nuk mund të bëjnë rivlerësimin e ofertave pasi që sipas tij ky është thjeshtë një proces administrativ.

Provë 19: Ekspertiza e datës 18.11.2022

21. Paditësi brenda afatit i ka kthyer përgjigje panelit shqyrtues me të cilën e ka njoftuar se nuk pajtohet me ekspertin shqyrtues, duke i kujtuar të Paditurës se kërkesa për Autorizim Marketing është kërkesë e domosdoshme ligjore dhe se për këtë qëllim është shfuqizuar edhe Udhëzimi Administrativ 02/2014 si i paligjshëm e që për rezultat edhe po të nënshkruhej kontrata, operatori ankues nuk do të mund të importonte insulina në Kosovë. Po ashtu sa i përket validitetit të ofertave, Paditësi i ka kujtuar të Paditurës se në të paktën tetë vendime paraprake të OSHP-së në momentin që ofertat kanë pasur shprehje në validitet OSHP ka konstatuar se të njëjtat janë të papërgjegjshme dhe ka kërkuar që ndaj zyrtarit të merren masa disiplinore.

Provë 20: Përgjigja në ekspertizë e Paditëses

22. Me datën 21.12.2022 OSHP ka dërguar Vendimin me Nr. 596/22, tash e tutje referuar si “Vendimi i Atakuar” me të cilin ka aprovuar ankesën dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim me

sqarime të qarta se ankuesit duhet ti ipet kontrata edhe pse kjo bie në kundërshtim me Ligjin. Vendim i Atakuar, përveç rrezikimit direkt të shëndetit të përdoruesve të insulinave, përbën edhe precedent të rrezikshëm i cili praktikisht e bën të gjithë mandatin e Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale të panevojshëm dhe legjislationin farmaceutik të pazbatueshëm.

II. BAZA LIGJORE PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË ATAKUAR

23. Ministria e Shëndetësisë pas nxjerrjes së Vendimit të parë të OSHP-së për rivlerësimin e lëndës dhe kërkimin e sqarimeve shtesë nga AKPPM ka kryer një proces të gjerë të konsultimeve për të ardhur në përfundim nëse në tenderët e saj mund të prokuroj apo jo barna pa Autorizim Marketing. Për shkak se Ligji nr. 04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale, tash e tutje referuar si **“Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale,”** në Nenin 16, paragraf 1, shprehimisht parasheh që **“[p]rodukti medicinal mund të plasohet në Republikën e Kosovës vetëm pas marrjes së Autorizimit për Marketing nga AKPPM.”** Kjo kërkesë që buron nga Ligji për Produkte e Pajisje Medicinale është e patejkalueshme dhe se asnjë akt nënligjor apo ligj i përgjithshëm procedural si Ligji i Prokurimit Publik, nuk mund të pezullojë veprimin e Nenit 16 të këtij ligji, veçanërisht në rrethanën konkrete kur ekziston produkti medicinal me Autorizimin për Marketing. Ministria e Shëndetësisë ka ardhur në përfundimin se Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale nuk lë hapësirë për interpretime të tjera, veçanërisht duke pas parasysh rëndësinë e Autorizimit për Marketing e cila është certifikatë/leje e dhënë nga AKPPM për aprovimin e barit për treg bazuar në plotësimin e kërkesave për kualitet, siguri dhe efikasitet për përdorim human në tretmanin terapeutik. Në këtë kuptim mbrojtja e shëndetit publik përkufizohet konkretisht në procedurat e aplikimit dhe përfuturit të Autorizimit për Marketing të përshkruara në të gjithë Nenin 16 të ligjit.

24. Për të trajtuar këtë çështje me datën 21 mars 2022 Departamenti i Farmacisë i është drejtuar me kërkesë për opinion ligjor Departamentit Ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë. Departamenti Ligjor ka kërkuar nga këshilltari i jashtëm ligjor i angazhuar nga Projekti i Bankës Botërore që në kuadër të kontratës së tij të bëjë draftin e opinionit ligjor për çështjen në fjalë. I njëjti me datën 25 mars 2022 ka dërguar draftin e opinionit ligjor për këtë çështje me të cilin ka konstatuar se Udhëzimi Administrativ është në kundërshtim me Ligjin për Produkte dhe Pajisje Medicinale dhe se Ministria e Shëndetësisë deri në amendamentimin apo shfuqizimin e Udhëzimit Administrativ, duhet të zbatoj dispozitat e normës më të lartë në hierarki që është Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale. Departamenti Ligjor pasi që ka pranuar dhe shqyrtuar opinionin ligjor është pajtuar në tërësi me të njëjtin dhe ka kërkuar që i njëjti të trajtohet si rekomandim i Departamentit Ligjor.

Provë 21: Opinion ligjor i datës 22 mars 2022 dhe shkresat përcjellëse duke përfshirë kërkesën e Departamentit të Farmacisë, Kërkesën për Sqarime nga Divizioni i Prokurimit

dhe pajtimin e Departamentit Ligjor me opinionin e këshilltarit të jashtëm ligjor të angazhuar me projektin e Bankës Botërore.

25. Deri tek ky opinion ligjor kishte ardhur edhe për shkak se Kryeshefi i AKPPM kishte konstatuar se emaili i Znj. Fikrije Hoti me të cilin kishte thënë se lejohet importi i insulinave pa Autorizim Marketing është i pasaktë dhe se interpretimet ligjore për çështjet e Ligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale duhet ti bëjë Departamenti Ligjor i Ministrisë së Shëndetësisë si sponzorizues i ligjit, ndërsa AKPPM është vetëm agjenci ekzekutive e cila i zbaton ligjet por nuk lëshon interpretime edhe për faktin se nuk ka departament ligjor.

Provë 22: Emaili i Kryeshefit të AKPPM Dr. Sc. Ardian Rugova

26. OSHP në Vendimin e Atakuar nuk i falë besimin Departamentit Ligjor të MSH, as Kryeshefit të AKPPM, as një vendimi të cilin e kishte nxjerr United Nations Office for Project Services (UNOPS) e cila përgjatë kohës sa tenderi ishte bllokuar në OSHP për mungesë Bordi ka bërë prokurimin e insulinave për nevojat e Ministrisë së Shëndetësisë. OSHP madje injoroi në tërësi edhe faktin se është shfuqizuar Udhëzim Administrativ 02/2014 dhe është aprovuar një i ri, pikërisht për të ndaluar rrezikimin e shëndetit publik në Kosovë. Për rezultat, operatori më tutje nuk do të mundet të bëjë importimin e produkteve të tij pa autorizim marketing.
27. Në kundërshtim me të gjitha këto praktika dhe interpretime të përmendura më lartë OSHP në vendimin e atakuar konstatoi: *“Pra me këtë nënkuptohet se AK me DT ka ofruar mundësinë e furnizimit qoftë me AM apo Leje importi duke shpjeguar në njëzim se, kërkesat e tilla kualifikuese janë në harmoni me nenin 70 i LPP-së sipas së cilit Autoriteti Kontraktues do t'i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ certifikues pavarësisht nga vendi, nëse organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i BE-së. Autoriteti kontraktues po ashtu pranon të dhënat e tjera të besueshme për masat e barasvlershme të sigurimit të cilësisë nga operatorët ekonomik që nuk kanë qasje ose mundësi për sigurimin e certifikatave të tilla brenda afateve të caktuara. Paneli Shqyrtues i OSHP, i mbështet shpjegimet e cituara si më sipër të Raportit të ekspertit shqyrtues.”* Bazuar në këtë konstatim OSHP vjen në konstatimin e gabuar se operatori Pharma Leader ka leje importi të produkteve pa Autorizim Marketing. Vlen të thuhet se i njëjti nuk ka leje të tillë dhe nuk mund të marrë një të tillë në të ardhmen për shkak të shfuqizimit të Udhëzimit Administrativ 02/2014. AKPPM i lëshon lejet e importit bazuar në seri të importit dhe se leja e tillë nuk lëshohet për të zëvendësuar Autorizimin për Marketing.

III. ME APROVIMIN E ANKESËS OSHP VENDOSI UDHËZIMIN ADMINISTRATIV TË SHFUQIZUAR MBI DISPOZITAT E LIGJIT PËR PRODUKTE DHE PAJISJE MEDICINALE

28. Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale në Nenin 16, paragraf 1, ka paraparë: “[p]rodukti medicinal mund të plasohet në Republikën e Kosovës vetëm pas marrjes së Autorizimit për Marketing nga AKPPM”. Sidoqoftë, në raste kur për sëmundje të caktuara prodhuesit nuk kanë interes të regjistrojnë produktet e tyre dhe personat fizik për nevoja personale kanë interes të importojnë barna pa Autorizim Marketing në sasi të arsyeshme, ligji e ka lejuar të njëjtën sipas Nenit 12 [Importi i Produkteve Medicinale] ku thuhet: “[p]ersonat fizik kanë të drejtë të importojnë sasi të arsyeshme të produkteve medicinale për një tretman, të nevojshme për përdorimin e tyre personal të dëshmuar me raportin mjekësor apo recetën nga mjeku dhe diagnozën e përcaktuar nga një qendër mjekësore në rastet kur këto produkte nuk kanë Autorizim Marketingu të lëshuar nga AKPPM, apo kanë Autorizim Marketingu të lëshuar nga AKPPM por nuk kanë licencë importi të lëshuar nga AKPPM brenda një (1) viti.” Në lidhje me këtë tolerim, ligji e lejon që individët të importojnë vet apo përmes kompanive të licencuara këto medikamente, por për nevoja personale dhe sipas përshkrimeve të recetave mjekësore.
29. Ligji e ka lejuar dhe autorizuar pra mundësinë e importit pa Autorizim Marketing dhe për këtë çështje ka thënë se Ministria e Shëndetësisë nxjerr akt nënligjor me të cilin specifikon procedurat e importit të këtyre produkteve. Neni 16, paragraf 11, thotë: “[m]inistria e Shëndetësisë rregullon thjeshtësimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve dhe pajisjeve medicinale që nuk kanë paralele të autorizuar në Republikën e Kosovës me akt nën-ligjor, në pajtim me këtë ligj.”
30. Në anën tjetër Udhëzimi Administrativ 02/2014 tanimë i shfuqizuar në Nenin 4, paragraf 1, përcakton se “1. Aplikacioni për import të produkteve medicinale të cilat nuk kanë paralele të regjistruara në Republikën e Kosovës mund të bëhet vetëm nga subjektet farmaceutike të licencuara nga AKPPM si Qarkullues me Shumicë i Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale.” Në këtë mënyrë Udhëzimi i lejon importet nga kompanitë e licencuara dhe jo nga individët për nevoja personale siç parashihet në Ligj. Kjo dispozitë ishte qartësisht në kundërshtim me qëllimin e Ligjit dhe mbi këtë dispozitë qëndron edhe kolizioni kryesor ligjor në mes të dy akteve.
31. Një tjetër dallim substancial në mes të Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ 02/2014 është edhe paragrafin 3, të Nenit 4, në të cilin thuhet: “[s]asia e produktit për import [pa Autorizim Marketing] do të jetë e pa limituar”. Në këtë mënyrë është shkelur dispozita ligjore e cila thotë se sasia duhet të jetë për nevoja të arsyeshme individuale dhe e njëjta dispozitë bie ndesh me Nenin 16, paragraf 11, ku thuhet se Udhëzimi Administrativ duhet të jetë në përputhje me Ligjin. Pra ligjvënësi nuk i ka dhënë të drejtë Ministrisë së Shëndetësisë që të ndryshoj dispozitat ligjore me Udhëzim Administrativ.

IV. MINISTRIA E SHËNDETËSISË KA BËRË NDRYSHIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV DHE HARMONIZIMIN ME LIGJ

32. Me të pranuar opinionin ligjor dhe konkluzionin se Udhëzimi Administrativ nuk është në harmoni me Ligjin, Sekretari i Përgjithshëm e ka njoftuar Ministrin për këtë situatë dhe ka

kërkuar ndryshimin e planit legjislativ ku është futur në agjendë rishikimi i këtij udhëzimi administrativ.

33. Ministria e Shëndetësisë për këtë qëllim me datë 19.10.2022 ka themeluar grupin punues i cili do të harmonizoj dispozitat e Udhëzimit Administrativ me Ligjin. Që do të thotë se e vetmja bazë ligjore ku OSHP mbështetë vendimin e atakuar nuk do të ekzistoj edhe më tutje. Me rastin e ndryshimit të këtij udhëzimi operatori nuk do të ketë më tutje të drejtë të importoj produkte pa Autorizim Marketing dhe në këtë formë kontrata do të bëhej e pazbatueshme.

Provë 23: Shkresa e Ministrit për lejimin e ndryshimit të UA

34. Pas plotësimit të planit Legjislativ, Qeveria nxjerr Vendim për anashkalimin e të gjitha procedurave të konsultimeve publike dhe lejon ndryshimin e Udhëzimit të kundërligjshëm me procedura të përshpejtuara, duke parë rrezikun e shëndetit kombëtar nga Vendimi i të Paditurës dhe efektet që mund të krijohen në praktikë. (Shih Provën 15: Shkresa e Kryeministrit me nr. 069/59). Duke vepruar mbi bazën e vendimeve të lartcekura është themeluar grupi punues i cili ka hartuar Udhëzimin e ri administrativ, i cili e pamundëson importin e pakufizuar të produkteve dhe pajisjeve medicinale pa Autorizim të Marketingut. (Shih Udhëzimin Administrativ për Thjeshtëzimin e për Regjistrimin dhe Importin e Produkteve Medicinale të cilat nuk kanë Paralele të Regjistruar në Republikën e Kosovës të datës 21.10.2022).
35. Me nxjerrjen e këtij Udhëzimi të ri është mbyllur çdo paqartësi eventuale mbi mundësinë e shitjes së barnave të palejuara me Autorizim Marketing në Kosovë dhe tutje edhe po të ipet kjo Kontratë sipas kërkesave të paligjshme të OSHP-së, ajo nuk mund të zbatohet më tutje, pasi që AKPPM nuk do të lejoj as importin dhe as shitjen e tyre në treg. Për më tutje Neni 70 i Ligjit të Prokurimit Publik i cituar nga paneli dhe eksperti, nuk do të mund të zëvendësoj ligjin e veçantë me të cilin mbrohet shëndeti publik.

V. OSHP NXORRI VENDIM SA I PËRKET VALIDITETIT TË OFERTËS NË KUNDËRSHTIM ME PRAKTIKËN E VET

36. Oferta e operatorit Pharma Leader ka patur ndërprerje përkatësisht shkëputje të validitetit për 45 ditë, siç është theksuar edhe në Njoftimin për Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Pavarësisht se obligimi i kujt ka qenë që të kërkohet vazhdimi i validitetit, oferta ka pasur shkëputje dhe kjo e bënë të papërgjegjshme kompaninë. Diçka e tillë sqarohet me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik, dokument i cili ka qenë në fuqi në kohën e inicimit të këtij aktiviteti të prokurimit në të cilin thuhet: *"31.3 Periudha e validitetit të tenderit e specifikuar në dosjen e tenderit do të ndryshoj varësisht nga kompleksiteti i prokurimit. Periudha e kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës. 31.4 Nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të*

*finalizohet brenda afatit të përcaktuar të validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkojë nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe **duhet të kërkojë para datës së skadimit** (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit). 31.5 Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkojë **që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre.**"*

37. Pra edhe pse RRUOPP kërkon që kërkesa për validitet të bëhet nga AK, gjë që nuk është bërë, e për çka Ministria e Shëndetësisë merr përsipër të iniciojë procedura disiplinore ndaj zyrtarit përgjegjës, është konstatim se ka pasur shkelje të validitetit të ofertës. Kjo situatë sqarohet po ashtu edhe me pyetjet e shpeshta të KRPP përkatësisht pyetjen 69 ku thuhet: "Sipas nenit 31.4 të lartcekur, nuk përcaktohet sa ditë para skadimit të validitetit të ofertave mund të kërkojë zgjatja e afatit të validitetit të ofertave. Megjithatë, është e rëndësishme që të ketë kontinuitet midis afatit të skaduar dhe atij të ri, për këtë arsye në këtë dispozitë thuhet: **"para datës së skadimit..."** Pavarësisht se aktiviteti i prokurimit është në "Pezullim", AK në përputhje me nenin 31.4 të RRUOPP duhet që të kërkojë zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Asnjë dispozitë e LPP-së dhe e legjislacionit dytësor nuk përcakton përkufizimin e fjalës "Pezullim", megjithatë KRPP konsideron se fjala "Pezullim" në kuptim të këtij ligji duhet të nënkuptojë mosndërmarrjen e ndonjë hapi në procedurat e prokurimit për derisa aktiviteti i prokurimit është i pezulluar. (Psh: hapja e tenderëve nuk duhet të bëhet nëse aktiviteti i prokurimit është pezulluar si rezultat i Kërkesës për rishqyrtim e parashtruar në AK, apo e një ankese e parashtruar në OSHP gjatë fazës së tenderimit, apo nënshkrimi i kontratës nuk duhet të bëhet për deri sa aktiviteti i prokurimit është në pezullim si rezultat i parashtrimit të një kërkesë për rishqyrtim në AK, apo një ankese në OSHP). Neni 31.3 i RRUOPP kërkon rreptësisht që oferta të ketë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës. **Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës.** Për këtë arsye, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. **Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkojë zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit.** KRPP do të monitorojë me kujdesin e veçantë autoritetet kontraktuese për moszbatimin e nenit 31.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik dhe do të shqiptojë **"Vërejtje me shkrim"** në përputhje me Nenin 5, paragrafin 7 të Rregullores Nr. 2/2017 për Procedurat e Dhënies dhe Revokimit të Certifikatës Profesionale për Prokurimin Publik."
38. Nga përgjigja dhe interpretimi i KRPP është shumë e qartë se në mënyrë retroaktive nuk mund të vazhdojë validiteti i ofertës dhe as që mund të nënshkruhet kontratë me një operator të i cili ka pasur shkelje në validitetin e ofertës së tij.
39. Paditësi i ka sqaruar Bordit se sa i përket çështjes së validitetit të ofertës dhe shkeljes së validitetit ka praktika ku OSHP duhet të ruaj konsistencën dhe precedent të cilëve mund ti referohet duke përfshirë:

- a) PSH. Nr. 368-387/22
- b) PSH. Nr. 115/20 (OSHP kishte marrë vendim për anulim të aktivitetit të prokurimit për shkak të shkëputjes në validitet të ofertave edhe pse faji ishte i Autoritetit Kontraktues)
- c) PSH. Nr. 979/20 (OSHP ka anuluar aktivitetin për shkak të shkëputjes së validitetit të ofertës)
- d) PSH. Nr. 670/20 (OSHP ka anuluar aktivitetin e Ministrisë së Shëndetësisë për shkak të shkëputjes së validitetit të ofertave)
- e) PSH. Nr. 888/19
- f) PSH. Nr. 414/18
- g) PSH. Nr. 425/18
- h) PSH. Nr. 426/18

40. Pra, siç shihet është në përputhje me praktikën e OSHP që shkëputja e validitetit të ofertës të trajtohet në përputhje me Nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik, pra si shkelje ligjore e cila nuk mund të rikuperohet dhe për këtë arsye duhet të anulohet aktiviteti i prokurimit. Në rastin konkret, në vendimin e atakuar, e Paditura ka shkelur çdo praktikë të vetën në pesë vitet e fundit duke kërkuar vlerësimin e ofertës së skaduar.

VI. OSHP KA NXJERRË VENDIM PAS AFATIT NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN DHE PRAKTIKËN E SAJ

41. E Paditura si organ administrativ është e obliguar që vendimet e veta të nxjerr brenda afatit të paraparë ligjor me anë të Ligjit të Prokurimit Publik dhe në kuptim të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. E njëjta nuk mundet të nxjerr vendime pas afatit nëse nuk njofton për zgjatjen e afatit. Në rastin përkatës, çdo afat ligjor për nxjerrje të vendimit është tejkaluar, dhe në këtë mënyrë e Paditura ka vepruar në kundërshtim me rregullat për shqyrtimin e ankesës.
42. Sipas Ligjit të Prokurimit Publik Nenet 111 – 115 afati ligjor i Organit Shqyrtues të Prokurimit për nxjerrje të vendimit përfundimtar është 34 ditë dhe i njëjti në rast se lënda është e komplikuar mund të zgjas këtë afat edhe për 20 ditë të tjera. Mirëpo, në rastin përkatës e Paditura nuk ka njoftuar për zgjatjen e afatit që do të thotë se të njëjtës i ka kaluar afati për vendimmarrje dhe se vendimi i atakuar është i jashtë afatshëm. E Paditura vendimin e ka nxjerrë në afat prej 54 ditëve në kundërshtim me çdo normë dhe rregull ligjor të shqyrtimit të ankesës dhe nuk ka bërë njoftim për zgjatje të afatit.
43. Për më tepër afati për shqyrtimin e ankesës është paraparë edhe me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht Nenin 135 në të cilin thuhet: “Përpos kur ligji parasheh një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës.” Meqë afati për shqyrtimin e

ankesës është i paraparë se duhet të zgjidhet brenda afatit prekluziv prej 34 ditësh, dhe e Paditura ka dështuar që të nxjerr dhe njoftoj vendimin e vet brenda këtij afati, gjykata duhet ta trajtoj të njëjtin si të jashtëafatshëm dhe ta anulojë atë.

44. Çështja e afatit për nxjerrje të vendimit është e trajtuar shumë herë edhe me vendimet e vet të e Paditura, ku me qindra ankesa janë hudhur si jashtë afatit për shqyrtim, për shkak se Bordi nuk ka arritur që të nxjerr vendim brenda afatit ligjor të paraparë me Ligjin e Prokurimit Publik dhe brenda afatit të paraparë ligjor.

Provë 24: Vendimi Nr. 397/21 i datës 25.07.2021

Siç vërehet nga provat dhe thëniet e cekura si më lartë, Vendimi i Atakuar është i kundërligjshëm edhe për shkak të vet praktikës së institucionit, andaj si i tillë është i kundërligjshëm dhe zbatimi i tij nga ana e Paditësit do të ishte me pasoja dhe rrezik për shëndetin e përdoruesve të produkteve medicinale

Andaj, duke u bazuar pretendimet e cekura më lartë dhe bazuar në gjendjen faktike të përshkruar, si dhe në bazë të dispozitës së nenit 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative kërkojmë nga Gjykata që të nxjerrë këtë:

AKT GJYKIM

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e Paditësit Ministria e Shëndetësisë, me adresë në rrugën e Zagrebit Nr. 60 në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit ligjor e përfaqëson Dr. Naim Bardiqi Sekretari i Përgjithshëm.

ANULOHET tërësisht Vendimi i Atakuar nr. 596/22, i datës 21.12.2022, i nxjerrë nga e Paditura Organi Shqyrtues i Prokurimit. Për dhe në emër të Paditësit:

Dr. Naim Bardiqi
Sekretari i Përgjithshëm

